



**VENDIM**

**Nr. 37 Datë 13.05.2014**

**PËR**

**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT  
TË SHOQËRISË “BISTRICA 3 ENERGY” SH.P.K PËR  
KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES NGA HEC- ET  
“BISTRICA 3” DHE “BISTRICA 4”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “ll”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 6; 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007; nenit 18 pika 1 gërma “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për Hec- et “Bistrica 3” dhe “Bistrica 4”, si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatohet se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “BISTRICA 3 ENERGY” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**  
Përshkrimi i centralit..  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “BISTRICA 3 ENERGY” sh.p.k, për kualifikimin e impiantit prodhues nga Hec- et “Bistrica 3” dhe “Bistrica 4”, si burim i rinovueshëm energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.